



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR**

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2021

**VENDIM**

**Nr.193, datë 12.05.2021**

**PËR  
MIRATIMIN E “METODOLOGJIA E PIKËZIMIT ME QËLLIM PËRCAKTIMIN E  
NIVELIT TË VLERËSIMIT TË NDIHMËSMAGJISTRATIT NË GJYKATËN E  
LARTË”**

Këshilli i Lartë Gjyqësor bazuar në nenin 147 pika 1 shkronja “a” të Kushtetutës, si dhe në nenet 2, 56, 68-72, 74-78, 84-95, 97 dhe 171 të ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, me propozimin e Komisionit të Etikës dhe Vlerësimit Profesional,

**VENDOSI :**

1. Miratimin e “Metodologjia e pikëzimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të ndihmësmagjistratit në Gjykatën e Lartë”, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë e “Skemës së Vlerësimit të Gjyqtarëve”.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e botimit në Fletoren Zyrtare

**PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR**

## **METODOLOGJIA E PIKËZIMIT ME QËLLIM PËRCAKTIMIN E NIVELIT TË VLERËSIMIT TË NDIHMËSMAGJISTRATIT NË GJYKATËN E LARTË**

1. Metodologjia e pikëzimit ka për qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të ndihmësmagjistratit në Gjykatës së Lartë për secilin kriter dhe treguesit përkatës ligjor, mbi bazën e një sistemi pikësh të përcaktuar mbi meritat, kualifikimin, integritetin, aftësinë dhe efikasitetin e tij, gjatë ushtrimit të detyrës.
2. Metodologjia e pikëzimit është pjesë përbërëse e “Skemës së Vlerësimit”, sipas përcaktimeve të nenit 2 shkronja “ll” dhe nenit 70 pika 3 të ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.
3. Me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të ndihmësmagjistratit, pikëzimi bëhet duke u bazuar në kriteret e posaçme të parashikuar në nenet 56, paragrafi 5, 68-72, 74-78, 84-95 dhe 97 të ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” të cilat aplikohen për aq sa gjejnë zbatim.
4. Për aq sa ligji e lejon, përcaktimi i treguesve shtesë të çdo kriteri vlerësues dhe pesha specifike e tyre bëhet në tabelën e pikëzimit, pjesë e kësaj metodologjie.
5. Vlerësimi i ndihmësmagjistratit kryhet bazuar në kriteret e mëposhtme:
  - a) aftësitë profesionale;
  - b) aftësitë organizative;
  - c) etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale;
  - ç) aftësitë personale dhe angazhimi profesional.
6. Vlerësimi kryhet sipas këtyre niveleve:
  - a) Vlerësimi i përgjithshëm “Shkëlqyeshëm” jepet në ato raste kur ndihmësmagjistrati është vlerësuar “Shkëlqyeshëm” për të katër kriteret.
  - b) Vlerësimi i përgjithshëm “Shumë mirë” jepet vetëm në ato raste kur ndihmësmagjistrati vlerësohet “Shumë mirë” për tre kriteret dhe “Mirë” për njërin prej tyre. Në çdo rast, kriteret “aftësitë profesionale” dhe “etika dhe angazhimi ndaj vlerave të gjyqësorit” duhet të jenë vlerësuar “Shumë mirë”.
  - c) Vlerësimi i përgjithshëm “Mirë” jepet në rastin kur aftësitë vlerësohen “Mirë” për dy kriteret dhe “Mjaftueshëm” për dy kriteret e tjera. I njëjti rregull zbatohet edhe në rastin kur ka barazi në vlerësimin e kriterëve në nivelet “Mjaftueshëm” dhe “I pamjaftueshëm”. Në çdo rast, kriteret “aftësitë profesionale” dhe “etika dhe përkushtimi ndaj vlerave të gjyqësorit” duhet të vlerësohen të paktën “Mirë”.
  - d) Vlerësimi i përgjithshëm “I pamjaftueshëm” jepet në këto raste:
    - i. kur ndihmësmagjistrati vlerësohet “I pamjaftueshëm” për të paktën në 3 kriteret;

- ii. kur ndihmësmagjistrati vlerësohet “I pamjaftueshëm” për kriteret “aftësitë profesionale” dhe “etika dhe angazhimi ndaj vlerave të gjyqësorit” dhe jo më shumë se “Mirë” për dy kriteret e tjera.

Për çdo kombinim tjetër të ndryshëm nga ato të parashikuar më lart, niveli i përgjithshëm i vlerësimit do të përcaktohet në varësi të mesatares së pikëve të katër kriterëve, sipas shkallës së pikëzimit të përcaktuar në pikën 9 të kësaj metodologjie. Në çdo rast niveli i përgjithshëm i vlerësimit, nuk mund të jetë më i lartë, se niveli i vlerësimit për kriteret “aftësitë profesionale” dhe “etika dhe angazhimi ndaj vlerave të gjyqësorit”.

7. Niveli i vlerësimit përcaktohet për çdonjërin nga katër kriteret e vlerësimit.
8. Niveli i vlerësimit për çdonjërin nga kriteret e vlerësimit, përcaktohet mbi bazën e një shkalle pikëzimi nga 1 deri në 100 pikë.
9. Shkalla e pikëzimit që përcakton nivelet e vlerësimit është:
  - a) 90 deri 100 pikë “Shkëlqyeshëm”;
  - b) 70 deri 89 pikë “Shumë mirë”;
  - c) 50 deri në 69 pikë “Mirë”;
  - d) 30 deri në 49 pikë “Mjaftueshëm” dhe;
  - e) 1 deri në 29 pikë “Pamjaftueshëm”.
10. Brenda çdo kriteri vlerësimi bëhet ndarja e pikëve sipas rëndësisë së çdo treguesi vlerësimi duke shmangur përfundime që nuk janë përgjegjësi e ndihmësmagjistratit.
11. Në tabelën e pikëzimit përcaktohet ndarja e kriterëve të vlerësimit, lista e aspekteve të çdo kriteri, treguesit e vlerësimit dhe pikëzimi i tyre sipas nivelit, në funksion të pikëzimit dhe të vlerësimit final të ndihmësmagjistratit.

## 1. AFTËSITE PROFESIONALE (100 pikë)

### A. Njohuritë ligjore (50 pikë)

- a. Aftësia për të identifikuar natyrën e çështjes, ligjin e zbatueshëm dhe/ose konfliktin e normave (25 pikë)
- b. Aftësia për të interpretuar ligjin në çështjet ligjore materiale ose procedurale, për të cilat i kërkohet përgatitja e dokumentit ligjor (25 pikë)

### B. Arsyetimi ligjor (50 pikë)

- a. Qartësia, konciziteti dhe kuptueshmëria e dokumentit ligjor (15 pikë)
- b. Struktura e qëndrueshme dhe e mirëorganizuar e dokumentit ligjor (10 pikë)
- c. Cilësia e analizës dhe e argumentimit logjik (25 pikë)

## 3. ETIKA DHE ANGAZHIMI NDAJ VLERAVE PROFESIONALE (100 pikë)

### A. Etika në punë (35 pikë)

- a. Angazhimi dhe përgjegjshmëria në funksion (35 pikë)

### B. Integriteti (40 pikë)

- a. Shmangia e shfaqjes së pahijshme, nderi dhe dinjiteti (40 pikë)

## 2. AFTËSITË ORGANIZATIVE (100 pikë)

### A. Aftësia për të përballuar ngarkesën e punës (Treguesi sasior) (30 pikë)

- a. Treguesi sasior në përfundimin e dokumenteve ligjore për çështjet gjyqësore (15 pikë)
- b. Rendimenti i përfundimit të dokumenteve ligjore për çështjet gjyqësore (15 pikë)

### B. Aftësia për të përfunduar në kohë çështjet e ngarkuara (Treguesi i shpejtësisë) (35 pikë)

- a. Respektimi i standardit minimal kohor (15 pikë)
- b. Koha mesatare që i dedikohet çdo çështjeje të përgatitur për relativitet (20 pikë)

### C. Metodologjia e punës (Aftësia për të qenë efektiv në menaxhimin e kohës) (35 pikë)

- a. Aftësia për të evidentuar dhe kryer veprimet e nevojshme dhe shmangien e veprimeve joproduktive në funksion të organizimit të procesit gjyqësor (15 pikë)
- b. Aftësia për të evidentuar brenda çështjeve të caktuara për relativitet, ato që kërkojnë vëmendje të posaçme dhe që duhet të trajtohen me përparësi për shkak të kërkesave procedurale (10 pikë)
- c. Rregullshmëria, saktësia e plotësia e dosjes gjyqësore (10 pikë)

## 4. AFTËSITË PERSONALE DHE ANGAZHIMI PROFESIONAL (100 pikë)

### A. Aftësitë e komunikimit (40 pikë)

- a. Komunikimi i qartë dhe transparent (25 pikë)
- b. Respektimi i konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale (15 pikë)

**C. Paanësia (25 pikë)**

- a. Përdorimi ose jo i gjuhës diskriminuese (10 pikë)
- b. Numri i tejet i lartë i kërkesave për heqje dorë të refuzuara nga Kryetari (15 pikë)

**B. Aftësia për të bashkëpunuar (25 pikë)**

- a. Gatishmëria dhe shkalla e komunikimit me kolegët duke përfshirë shkëmbimin e njohurive dhe të përvojës profesionale me ta (10 pikë)
- b. Gatishmëria dhe kontributi për të kryer edhe detyra të tjera që i ngarkohen nga organet drejtuese të Gjykatës (5 pikë)
- c. Aftësia për të bashkëpunuar dhe për të reaguar me efikasitet në rast nevoje (10 pikë)

**C. Gatishmëria për t'u angazhuar në veprimtari të tjera (35 pikë)**

- a. Pjesëmarrja në formimin vazhdues të Shkollës së Magjistraturës dhe në trajnime të tjera profesionale (25 pikë)
- b. Disponueshmëria e ndihmësmagjistratit për trajnimin e gjyqtarëve (5 pikë)
- b. Pjesëmarrja në veprimtari ndër-institucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësisë (5 pikë)
- c. Publikimet ligjore akademike (5 pikë)

## **PËRKUFIZIMET**

Përkufizime të nevojshme për t'u mbajtur parasysh me qëllim vlerësimin e ndihmësmagjistratit sipas kësaj metodologjie:

- 1) “Çështje e caktuar për relativim”, nënkupton çdo çështje të regjistruar në gjykatë, që i jepet ndihmësmagjistratit me qëllim përgatitjen nga ana e tij të dokumentit ligjor (analizë ligjore e çështjes, opinion ligjor dhe/ose material tjetër ndihmës lidhur me të), në funksion të relativimit nga ana e gjyqtarit në kolegji.
- 2) “Çështje të përfunduara” nënkupton të gjitha çështjet për të cilat Kolegji përkatës i Gjykatës së Lartë është shprehur me vendim, në dhomë këshillimi apo seancë gjyqësore.
- 3) “Çështje të papërfunduara” nënkupton të gjitha ato çështje për të cilat ndihmësmagjistrati ka përgatitur dokumentin ligjor, në funksion të relativimit nga ana e gjyqtarit në Kolegji, por që për arsye që lidhen me ecurinë procedurale të çështjeve në Gjykatën e Lartë, nuk është shqyrtuar ende nga kolegji përkatës.
- 4) “Çështje të përgatitura për relativim” nënkupton tërësinë e çështjeve të përfunduara dhe të papërfunduara nga ndihmësmagjistrati, gjatë periudhës së vlerësimit.
- 5) “Çështje të përzgjedhura me short”, nënkupton çështjet e përfunduara të përzgjedhura me short për vlerësim.
- 6) “Dokumente ligjore” janë dokumentet e hartuara dhe të dorëzuara nga ndihmësmagjistrati në kuadër të veprimtarisë gjyqësore që shërbejnë për vlerësimin e tij profesional, ku përfshihen: analiza, opinione, materiale studimore krahasimore mbi kuadrin ligjor dhe jurisprudencial vendas dhe të huaj, raporte dhe materiale të tjera që i kërkohen nga organet drejtuese të Gjykatës, etj.
- 7) “Gjyqtar relator” është gjyqtari i Gjykatës së Lartë i caktuar me short në cilësinë e relatorit të trupit gjykues për gjykimin e një çështje gjyqësore.
- 8) “Kolegji” nënkupton kolegjin civil, penal ose administrativ të Gjykatës së Lartë, pranë të cilit ndihmësmagjistrati ka ushtruar funksionin gjatë periudhës së vlerësimit.
- 9) “Kryetari” është Kryetari i Gjykatës së Lartë.
- 10) “Këshilli” është Këshilli i Lartë Gjyqësor.

## 1. AFTËSIA PROFESIONALE E NDIHMËSMAGJISTRATIT (100 pikë)

Për të pikëzuar aftësinë e ndihmësmagjistratit në drejtim të aspekteve të njohurive ligjore dhe arsyetimit ligjor, vlerësuesi përqendrohet në metodologjinë e përgjithshme të punës së tij bazuar në çështjet e përzgjedhura dhe nuk vlerëson nëse opinioni i tij ligjor përputhet apo jo me vendimin e marrë nga gjykata.

Vlerësuesi çmon aftësitë pa gjykuar korrektësinë e analizës ligjore të çështjes, si dhe pa zëvendësuar interpretimin ose logjikën e ndihmësmagjistratit që vlerësohet.

### A. Njohuritë ligjore (50 pikë)

#### **a. Aftësia për të identifikuar natyrën e çështjes, ligjin e zbatueshëm dhe/ose konfliktin e normave (25 pikë)**

Për të pikëzuar këtë aftësi, vlerësuesi përqendrohet në dokumentet ligjore të dorëzuara nga ndihmësmagjistrati, formularin e vetëvlerësimit, mendimin e Kolegjit si dhe në relacionin/opinionin e përgatitur prej tij për çdo çështje të përzgjedhur me short. Vlerësohet aftësia e ndihmësmagjistratit për të përcaktuar dhe renditur rrethanat e çështjes, ecurinë procedurale të saj, shkaqet e rekursit/investimit të Gjykatës së Lartë, identifikuar natyrën e mosmarrëveshjes, ligjin e zbatueshëm, konfliktin e normave sipas rastit. Gjithashtu, vlerësohet aftësia e ndihmësmagjistratit për t'i parashtruar verbalisht çështjet e mësipërme, kur i kërkohet nga gjyqtari relator/Kolegji.

Shkalla e aftësisë	Nr. i pikëve
E dobët	5
Nën mesataren	10
Mesatare	15
Mbi mesataren	20
Shumë e lartë	25

#### **b. Aftësia për të interpretuar ligjin në çështjet ligjore materiale ose procedurale, për të cilat i kërkohet përgatitja e analizës apo opinionit ligjor (25 pikë)**

Për të pikëzuar aftësinë e ndihmësmagjistratit për të interpretuar ligjin, vlerësuesi përqendrohet në dokumentet ligjore të hartuara dhe dorëzuara prej tij, formularin e vetëvlerësimit, mendimin e Kolegjit si dhe relacionet/opinionet e çështjeve të përzgjedhura me short. Këtu vlerësohet aftësia e ndihmësmagjistratit për të interpretuar ligjin e identifikuar, analiza e tij për mënyrën e zbatimit të ligjit mbi faktet objekt gjykimi dhe shkaqet e ngritura në rekurs, të cilat vlerësohen në kontekst të çështjes. Vetëm referimi formal i ligjit, i pashoqëruar me një analizë të dispozitave, raportit

midis tyre dhe zbatimit mbi rrethanat e faktit, sipas rastit mund të jetë tregues i mungesës së aftësive për të interpretuar ligjin.

Vlerësohet gjithashtu aftësia e ndihmësmagjistratit për t'u bazuar tek parimet e përgjithshme të së drejtës materiale e procedurale që kanë lidhje me interpretimin e ligjit në zgjidhjen e çështjes, për të kërkuar, njohur dhe analizuar jurisprudencën vendase dhe ndërkombëtare/GJEDNJ, duke u përqendruar tek një çështje të caktuar. Vlerësohet sa dhe si ndihmësmagjistrati identifikon praktikën gjyqësore vendase dhe atë ndërkombëtare, në mbështetje të një vendimi ose interpretimi të caktuar, si përdor dhe krahason burime jurisprudenciale nga sistemi ligjor vendas dhe nga sisteme të tjera.

Në veçanti, vlerësohet nëse ai i referohet me korrektesë, në vendin dhe në kontekstin e duhur, sipas qëllimit të çështjes : praktikës së konsoliduar gjyqësore, praktikës njësuere të Gjykatës së Lartë, të Gjykatës Kushtetuese, të GJEDNJ-së dhe të gjykatave të tjera ndërkombëtare edhe në rastet kur ato nuk janë burim të së drejtës, por i shërbejnë interpretimit të ligjit në kuadër të përafrimit të legjislacionit.

Shkalla e aftësisë	Nr. i pikëve
E dobët	5
Nën mesataren	10
Mesatare	15
Mbi mesataren	20
Shumë e lartë	25

## B. Arsyetimi ligjor (50 pikë)

### **a. Qartësia, konciziteti dhe kuptueshmëria e dokumentit ligjor (15 pikë)**

Ky tregues pikëzohet referuar : qartësisë, koncizitetit, elokuencës, dhe lehtësisë në kuptim dhe lexim të dokumenteve ligjorë; aftësisë së ndihmësmagjistratit për të prezantuar verbalisht para kolegjit, kur i kërkohet; aftësisë për të përmbledhur shkaqet e rekursit, procedurës së zbatueshme, arsyetimit të gjykatave më të ulëta dhe çështjeve të tjera ligjore. Vlerësohet përdorimi i thjeshtë dhe i drejtpërdrejtë i gjuhës; aftësia për të shprehur mendimin qartë dhe në mënyrë të përmbledhur; zbatimi i saktë i rregullave gramatikore dhe atyre të sintaksës; përzgjedhja e kujdesshme e gjuhës dhe përdorimi i të gjitha shkronjave të alfabetit shqip (ë dhe ç), paragrafëve dhe e strukturës së fjalisë për të shprehur kuptimin; përdorimi në mënyrë korrekte dhe konsistente i termave teknikë.

Për të pikëzuar këtë tregues, vlerësuesi përqendrohet në dokumentet ligjore të hartuara dhe të dorëzuara prej tij, formularin e vetëvlerësimit, mendimin e Kolegjit si dhe relacionet/opinionet e çështjeve të përzgjedhura me short.

Shkalla e aftësisë	Nr. i pikëve
--------------------	--------------



E dobët	3
Nën mesataren	6
Mesatare	9
Mbi mesataren	12
Shumë e lartë	15

### **b. Struktura e qëndrueshme dhe e mirëorganizuar e dokumentit ligjor (10 pikë)**

Për të pikëzuar këtë tregues vlerësohet nëse dokumentet ligjorë të dorëzuar nga ndihmësmagjistrati e ato të përzgjedhura me short përmbajnë një strukturë të qartë, të qëndrueshme, të mirëorganizuar, të cilës ndihmësmagjistrati i përmbahet me përpikëri gjatë prezantimit të fakteve, në identifikimin e ligjit të zbatueshëm dhe lidhjes së tyre me konkluzionet e arritura. Në veçanti, vlerësohet ndjekja e një metodologjie të caktuar sipas pjesëve përbërëse të dokumentit ligjor, në funksion të orientimit të lexuesit dhe kuptueshmërisë së përmbajtjes së dokumentit.

Për të pikëzuar këtë tregues, vlerësuesi përqendrohet në dokumentet ligjore të hartuara dhe dorëzuara prej tij, formularin e vetëvlerësimit, mendimin e Kolegjit si dhe relacionet/opinionet e çështjeve të përzgjedhura me short.

Shkalla e aftësisë	Nr. i pikëve
E dobët	2
Nën mesataren	4
Mesatare	6
Mbi mesataren	8
Shumë e lartë	10

### **c. Cilësia e analizës dhe argumentimit logjik (25 pikë)**

Për të pikëzuar këtë tregues vlerësohet cilësia e analizës mbi bazën e një zhvillimi logjik të koncepteve ligjore. Argumentimi logjik nënkupton aftësinë e ndihmësmagjistratit për të identifikuar marrëdhëniet shkak-pasojë, si edhe për të analizuar se si konceptet, institutet e së drejtës dhe dispozitat lidhen midis tyre, ose se si ato zbatohen në një situatë të caktuar. Në veçanti, në dokumentet ligjorë të hartuara dhe dorëzuar prej tij si dhe ato të përzgjedhura me short, vlerësohet nëse përmbajtja është gjithëpërfshirëse, duke u dhënë përgjigje të gjitha çështjeve ligjore që ngrihen për diskutim. Evidentimi dhe parashtrimi i nevojës për të njësuar apo ndryshuar praktikën e gjykatës është një tregues tjetër i aftësisë analitike ligjore të ndihmësmagjistratit.

Për të pikëzuar këtë tregues, vlerësuesi përqendrohet në dokumentet ligjore të hartuara dhe dorëzuara prej tij, formulari i vetëvlerësimit, mendimi i Kolegjit si dhe relacionet/opinionet e çështjeve të përzgjedhura me short.

Shkalla e aftësisë	Nr. i pikëve
E dobët	5
Nën mesataren	10
Mesatare	15
Mbi mesataren	20
Shumë e lartë	25

## 2. AFTËSIA ORGANIZATIVE E NDIHMËSMAGJISTRATIT (100 pikë)

Megjithëse përgjegjësitë e ndihmësmagjistratit në Gjykatën e Lartë ndryshojnë nga ato të gjyqtarit, edhe prej tij kërkohen aftësi të mira organizative në mënyrë që të ndikojë në rritjen e efektivitetit të Gjykatës së Lartë ku është i komanduar. Gjyqtari i Gjykatës së Lartë mund të jetë më shumë ose më pak efektiv, midis të tjerave, edhe në varësi të ndihmës dhe kontributit që jep ndihmësmagjistrati në shqyrtimin e çështjeve. Produktiviteti është rrjedhojë e menaxhimit të kohës, i cili tregon sa mirë ndihmësmagjistrati përdor kohën e tij, në funksion të shqyrtimit të çështjeve nga Kolegji.

Ashtu si gjyqtari, edhe ndihmësmagjistrati duhet të bëjë përpjekje maksimale në menaxhimin efektiv të kohës, si në planifikimin e çështjeve që ai përgatit në funksion të shqyrtimit të çështjeve gjyqësore nga gjykata në dhomë këshillimi ose seancë gjyqësore, ashtu edhe në veprimet procedurale jashtë tyre, pa krijuar pengesa në ecurinë e gjykimit të çështjeve në kolegje. Ky komponent vlerësohet sipas tre aspekteve : sasisë, shpejtësisë dhe metodologjisë.

### A. Aftësia për të përballuar ngarkesën në punë (30 pikë)

#### a. Treguesi sasior në përfundimin e dokumenteve ligjore për çështjet gjyqësore (15 pikë)

Aspekti sasior nënkupton aftësinë e ndihmësmagjistratit për të përballuar ngarkesën e punës, sipas një standardi minimal të caktuar nga Mbledhja e Gjyqtarëve dhe urdhri i Kryetarit për Njësinë e Shërbimit Ligjor, për çdo kategori çështjesh. Për të pikëzuar këtë tregues, vlerësimi bëhet nëpërmjet krahasimit të numrit total të çështjeve të përgatitura për shqyrtim (të përfunduara + të papërfunduara), me standardin sasior të përcaktuar. Realizimi i ngarkesës në punë matet duke përdorur si burim vlerësimi të dhënat statistikore, vetëvlerësimin e kryer nga ndihmësmagjistrati, mendimin e Kolegjit dhe mendimin e Kryetarit.

Për efekt të këtij vlerësimi, pikëzimi i ndihmësmagjistratit fillon që nga niveli më i ulët, i cili mund të jetë nën standardin minimal të përcaktuar nga Mbledhja e Gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë dhe/ose Kryetari, pasi pavarësisht mosrespektimit të sasisë së caktuar, ndihmësmagjistrati duhet të vlerësohet për punën e bërë. Të gjitha të dhënat statistikore analizohen sipas situatës, me qëllim për të shmangur përfundimet për çështje që nuk janë përgjegjësi e ndihmësmagjistratit.

Analiza e të dhënave statistikore bazohet në kompleksitetin e çështjeve, volumin e çështjeve, rritjen e papritur të volumit të çështjeve, dhe aspekteve të tjera që lidhen me kushtet e punës, të cilat mund të çojnë në një pikëzim më të lartë nga ai i tabelës së mëposhtme, deri në pikëzimin maksimal.

Shkalla e aftësisë	Nr. i pikëve
Nën standard	5
Në standard	10
Mbi standard	15

### **b. Rendimenti i përfundimit të dokumenteve ligjore për çështjet gjyqësore (15 pikë)**

Rendimenti i përfundimit të dokumenteve ligjore për çështjet gjyqësore është raporti midis çështjeve të përgatitura për shqyrtim (të përfunduara + të papërfunduara) pavarësisht kohës së caktimit të tyre, me numrin e çështjeve të caktuara për relativitet brenda një viti kalendarik. Për të pikëzuar këtë tregues Këshilli i referohet rendimentit të përfundimit të çështjeve i shprehur në përqindje.

Si burim vlerësimi shërbejnë të dhënat statistikore, vlerësimi i kryer nga ndihmësmagjistrati, mendimi i Kolegjit dhe mendimi i Kryetarit.

Të dhënat në përqindje ekuivalentohen në pikë sipas tabelës së pikëzimit.

Rendimenti	Nr. i pikëve
Nën 81 %	3
Mbi 81-87%	6
Mbi 87-93 %	9
Mbi 93-99 %	12
+99 %	15

Të gjitha të dhënat statistikore analizohen sipas situatës, me qëllim për të shmangur përfundimet për çështje që nuk janë përgjegjësi e ndihmësmagjistratit. Analiza e të dhënave statistikore bazohet në kompleksitetin e çështjeve, volumin e çështjeve, rritjen e papritur të volumit të çështjeve, dhe aspekteve të tjera që lidhen me kushtet e punës, të cilat mund të çojnë në një pikëzim më të lartë nga ai i tabelës së mësipërme, deri në pikëzimin maksimal, nëse ndihmësmagjistrati ka përfunduar brenda të njëjtit vit kalendarik më shumë se 50 % të standardit minimal sasior të përcaktuar nga Mbledhja e Gjyqtarëve dhe/ose Kryetari.

## **B. Aftësia për të përfunduar në kohë çështjet e ngarkuara (35 pikë)**

### **a. Respektimi i standardeve minimale kohore (15 pikë)**

Aspekti i shpejtësisë nënkupton aftësinë e ndihmësmagjistratit për të përgatitur dokumentin ligjor, brenda standardit minimal kohor të caktuar nga Mbledhja e Gjyqtarëve ose urdhri i Kryetarit për Njësinë e Shërbimit Ligjor, për çdo kategori çështjesh.

Për të pikëzuar këtë tregues, vlerësimi bëhet referuar raportit të çështjeve për të cilat dokumentet ligjorë janë përgatitur tej standardit, me totalin e çështjeve të përgatitura (të përfunduara + të papërfunduara). Si burim vlerësimi shërbejnë të dhënat statistikore, vetëvlerësimi i kryer nga ndihmësmagjistrati, mendimi i Kolegjit dhe mendimi i Kryetarit.

Të dhënat në përqindje ekuivalentohen në pikë sipas tabelës së pikëzimit.

Jashtë afatit	Nr. i pikëve
Mbi 40%	3
31-40%	6
21-30%	9
11-20%	12
0-10%	15

Të gjitha të dhënat statistikore analizohen sipas situatës, me qëllim për të shmangur përfundimet për çështje, që nuk janë përgjegjësi e ndihmësmagjistratit. Analiza e të dhënave statistikore bazohet në kompleksitetin e çështjeve, volumin e çështjeve, rritjen e papritur të volumit të çështjeve, si dhe aspekteve të tjera që lidhen me kushtet e punës, e cila mund të çojë në një pikëzim më të lartë nga ai i tabelës së mësipërme deri në pikëzimin maksimal.

### **b. Koha mesatare që i dedikohet çdo çështjeje të përgatitur për relativim (20 pikë)**

Për të pikëzuar këtë tregues, koha mesatare që i dedikohet përpunimit të dokumenteve ligjorë për çdo çështjeje nga ana e ndihmësmagjistratit, krahasohet me standardet kohore të përcaktuara nga Mbledhja e Gjyqtarëve për çdo kategori çështjesh. Koha mesatare përcaktohet më vete për secilën kategori çështjesh.

Si burim vlerësimi shërbejnë të dhënat statistikore, vetëvlerësimi i kryer nga ndihmësmagjistrati, dhe mendimi i Kolegjit dhe mendimi i Kryetarit.

Pikëzimi bëhet sipas tabelës së mëposhtme:

Koha mesatare	Nr. i pikëve
Më e gjatë se standardi për të gjitha kategoritë e çështjeve	1
Më e gjatë se standardi për shumicën e kategorive të çështjeve	5
Më e gjatë se standardi për gjysmën e kategorive të çështjeve	10
Më e shkurtër se standardi për shumicën e kategorive të çështjeve	15

Më e shkurtër ose e barabartë me standardin për të gjitha kategoritë e çështjeve	20
--	----

Të gjitha të dhënat statistikore analizohen sipas situatës, me qëllim për të shmangur përfundimet për çështje që nuk janë përgjegjësi e ndihmësmagjistratit. Analiza e të dhënave statistikore bazohet në kompleksitetin e çështjeve, volumin e çështjeve, rritjen e papritur të volumit të çështjeve, dhe aspekteve të tjera që lidhen me kushtet e punës, e cila mund të çojë në një pikëzim më të lartë nga ai i tabelës së mësipërme deri në pikëzimin maksimal.

**a. Metodologjia e punës (Aftësia për të qenë efektiv në menaxhimin e kohës) (35 pikë)**

Aftësia e ndihmësmagjistratit për të qenë efektiv në menaxhimin e kohës dhe të burimeve të tjera, nënkupton të gjitha veprimet specifike të nevojshme të kryera prej tij dhe evidentimin e çështjeve që kërkojnë vëmendje të posaçme apo ndërmarrjen e veprimeve të menjëhershme procedurale nga gjyqtari relator. Në këtë tregues përfshihet edhe aftësia për të përdorur sa më mirë kohën dhe burimet në dispozicion për përfundimin e detyrave të ngarkuara në kohën e duhur në raport me sasinë e punës. Gjithashtu, këtu përfshihet aftësia për ruajtur dhe mirëmbajtur dosjet gjyqësore dhe materialet e tjera të nevojshme për çështjen.

**a. Aftësia për të evidentuar e kryer veprimet e nevojshme dhe shmangien e veprimeve joproductive në funksion të organizimit të procesit gjyqësor (15 pikë)**

Për të pikëzuar këtë tregues vlerësohet nëse ndihmësmagjistrati jep ndihmën dhe kontributin aktiv në kryerjen me efikasitet të veprimeve të tilla si:

- respektimin e rendit kronologjik të çështjeve për t'u përgatitur në përputhje me afatet ligjore;
- respektimin nga ana e ndihmësmagjistratit të afateve të përcaktuara nga gjyqtari relator/Kolegji, në funksion të afateve të parashikuara në ligj për përfundimin e gjykimit të një çështjeje;
- kryerjen e veprimeve përgatitore efektive dhe në kohë, në bashkëpunim me Kryesekretarinë e Gjykatës;
- planifikimin dhe zhvillimin e seancave gjyqësore me apo pa pjesëmarrjen e palëve (njoftimin, shpalljen etj.);
- dokumentimin e vendimeve dhe veprimeve të tjera procedurale;
- ndjekjen me rigorozitet të seancave apo diskutimeve për çështjen, nëse është rasti;
- ndihmën në përgatitjen e vendimit në formën që u njoftohet palëve, nëse kërkohet nga gjyqtari relator.

Pikëzimi bëhet sipas tabelës së mëposhtme:

Shkalla e aftësisë	Nr. i pikëve
E dobët	3
Nën mesataren	6
Mesatare	9

Mbi mesataren	12
Shumë e lartë	15

Si burim vlerësimi shërbejnë aktet e dosjeve të përzgjedhura me short, vetëvlerësimi i kryer nga ndihmësmagjistrati, mendimi i Kolegjit dhe mendimi i Kryetarit.

**b. Aftësia për të evidentuar brenda çështjeve të caktuara për relativitet, ato që kërkojnë vëmendje të posaçme dhe që duhet të trajtohen me përparësi për shkak të kërkesave procedurale (10 pikë)**

Për të pikëzuar këtë tregues vlerësohet nëse ndihmësmagjistrati arrin të evidentojë shpejt dhe pa humbur kohë çështje që kërkojnë vëmendje të posaçme si p.sh: kërkesat për përshpejtim, kërkesat për pezullim, rastet kur kërkohet apo është e nevojshme përjashtimi i gjyqtarit relator nga gjykimi apo raste të tjera të ngjashme me këto. Kjo eviton vonesat në shqyrtimin e çështjeve që kërkojnë vëmendje të posaçme, për shkak të specifikës që mund të ketë çështja.

Pikëzimi bëhet sipas tabelës së mëposhtme:

Shkalla e aftësisë	Nr. i pikëve
E dobët	2
Nën mesataren	4
Mesatare	6
Mbi mesataren	8
Shumë e lartë	10

Si burim vlerësimi shërbejnë aktet e dosjeve të përzgjedhura me short, vetëvlerësimi i kryer nga ndihmësmagjistrati, mendimi i Kolegjit dhe mendimi i Kryetarit.

**c. Rregullshmëria, saktësia e plotësia e dosjes gjyqësore (10 pikë)**

Treguesi i rregullshmërisë vlerësohet dhe pikëzohet në bazë të kujdesit të treguar nga ndihmësmagjistrati për ruajtjen e renditjes së akteve të dosjes dhe materialeve të tjera dokumentare, në mënyrë të tillë që dosja të jetë lehtësisht e shfrytëzueshme. Vlerësohet aftësia e ndihmësmagjistratit për të garantuar rregullshmërinë, plotësinë dhe saktësinë e dokumenteve pjesë e dosjes gjyqësore që krijohet në Gjykatën e Lartë, që nga momenti i marrjes së saj, deri në dorëzimin e saj në sekretari pas përfundimit të çështjes.

Si burim vlerësimi shërbejnë aktet e dosjeve të përzgjedhura me short, vetëvlerësimi i kryer nga ndihmësmagjistrati, mendimi i Kolegjit dhe mendimi i Kryetarit.

Pikëzimi bëhet sipas tabelës së mëposhtme:

Shkalla e aftësisë	Nr. i pikëve
--------------------	--------------

E dobët	2
Nën mesataren	4
Mesatare	6
Mbi mesataren	8
Shumë e lartë	10

### 3. ETIKA DHE ANGAZHIMI NDAJ VLERA VE PROFESIONALE (100 pikë)

Pikëzimi i treguesve të këtij kriteri vlerësimi, bëhet sipas një rendi zbritës, bazuar në parimin kushtetues që çdo ndihmësmagjistrat pavarësisht institucionit ku kontribuon është së pari gjyqtar dhe për këtë arsye ai duhet të kujdeset gjatë gjithë kohës që të ruajë dhe kultivojë etikën, integritetin dhe paanësinë e tij. Çdo ndihmësmagjistrat e fillon procesin e vlerësimit me totalin e 100 pikëve referuar këtij kriteri të vlerësimit. Gjatë procedurës së vlerësimit, pikët mund të zbriten në varësi të problematikave të shfaqura në lidhje me çdo tregues të dalë nga burimet e vlerësimit krahasuar me ligjin, standardet e etikës dhe rregullat e sjelljes të miratuara nga Këshilli, Kodi i Etikës Gjyqësore, të cilat interpretohen në përputhje me Parimet e Bangalorit për sjelljen gjyqësore dhe komentari përkatës,<sup>1</sup> si edhe parimet për etikën gjyqësore të përpunuara nga Rrjeti Evropian i Këshillave Gjyqësorë (ENCJ).<sup>2</sup>

#### A. Etika në punë (35 pikë)

##### a. Angazhimi dhe përgjegjshmëria në funksion (35 pikë)

Etika në punë, me qëllim vlerësimin e angazhimit dhe përgjegjshmërisë në funksion, nënkupton sjelljen e kujdeshme, objektive, me vetëpërbajtje dhe maturi të ndihmësmagjistratit gjatë ushtrimit të detyrës, në mënyrë korrekte, të ndërgjegjshme, sistematike dhe në kohë të arsyeshme.

Përbushja e këtij detyrimi profesional kërkon që ndihmësmagjistrati në ushtrimin e detyrës duhet të tregojë dhe të provojë se në mënyrë të ndërgjegjshme dhe me vërtetësi, shmang çdo sjellje që tregon mungesë respekti, vetëpërbajtjeje, ndjeshmërie, vëmendjeje apo qasje të papërshtatshme dhe ofensive, duke mos u kufizuar vetëm në shmangien e sjelljeve që formalisht kualifikohen si në kundërshtim me ligjin.

Pikëzimi bëhet sipas tabelës së mëposhtme:

Shkalla e etikës në punë	Nr. i pikëve
E dobët	7
Nën mesataren	14
Mesatare	21

<sup>1</sup> UNODC, Komentari për Parimet themelore të Bangalorit për Etikën Gjyqësore, Shtator 2007, [https://www.unodc.org/documents/corruption/publications\\_unodc\\_commentary-e.pdf](https://www.unodc.org/documents/corruption/publications_unodc_commentary-e.pdf)

<sup>2</sup> Raporti për etikën gjyqësore i grupit të punës së ENCJ-së, 2009-2010, <https://www.encj.eu/images/stories/pdf/ethics/judicialethicsdeontologiefinal.pdf>

Mbi mesataren	28
Shumë e lartë	35

Vlerësuesi përqendrohet në vendimet përfundimtare për masat disiplinore brenda periudhës së vlerësimit, rezultatet e ankesave dhe verifikimin e tyre, në vetëvlerësimin e kryer nga ndihmësmagjistrati, në mendimin e Kolegjit dhe në mendimin e Kryetarit.

## **B. Integriteti (40 pikë)**

### **a. Shmangia e shfaqjes së pahijshme, nderi dhe dinjiteti (40 pikë)**

Integriteti i ndihmësmagjistratit, në kuadër të vlerësimit etik dhe profesional të tij, nënkupton imunitetin e tij ndaj çdo ndikimi dhe presioni të jashtëm në ushtrimin e detyrës.

Parimet e Bangalorit parashtojnë se nuk ka shkallë integriteti të përkufizuara si të tilla. Integriteti është një karakteristikë që një person e ka ose jo. Integriteti është absolut. Në gjyqësor, integriteti është më shumë se një virtyt, është një domosdoshmëri.

Prandaj, në përputhje me rrethanat, në caktimin e pikëve në dispozicion sipas këtij treguesi, Këshilli mund të marrë në konsideratë :

a) nëse ka informacione mjaftueshëm të besueshme se ndihmësmagjistrati i mungon integriteti, Këshilli do të caktojë minimumin e pikëve të mundshme.

b) nëse nuk ka informacione në dispozicion që tregojnë se ndihmësmagjistrati i mungon integriteti, konkluzioni duhet të jetë në favor të gjyqtarit dhe Këshilli do të caktojë maksimumin e pikëve të mundshme.

<b>Shkalla e integritetit</b>	<b>Nr. i pikëve</b>
E dobët	0
Shumë e lartë	40

Këshilli vlerëson nëse ndihmësmagjistrati respekton, miraton dhe mbështet vlerat themelore të punës së tij, siç janë shmangia e shfaqjes së pahijshme, nderi dhe dinjiteti, dhe i përgjigjet pritshmërive të publikut, duke demonstruar cilësitë personale të mençurisë, ndershmërisë, ndjenjës së humanizmit, guximit, seriozitetit dhe maturisë. Ndhmësmagjistrati duhet të jetë i vetëdijshëm se sjellja profesionale, jeta private dhe sjellja në shoqëri kanë ndikim në imazhin e drejtësisë dhe besimin e publikut.

*Shmangia e shfaqjes së pahijshme* është themelore për integritetin. Gjatë punës së tyre si ndihmësmagjistratë ata duhet të përpiqen të shmangin të gjitha paragjykimet që mund të dëmtojnë ose të konsiderohen si të dëmshme për gjykimin e tyre gjatë hartimit të dokumenteve ligjorë për çështjet në gjykim. Ndhmësmagjistratët, megjithëse nuk kryejnë funksione vendimmarrëse por ndihmëse, nuk duhet të mbajnë qëndrime favorizuese ose disfavorizuese në lidhje me çështjet për të cilat japin kontributin e tyre ndihmës për gjyqtarët në Gjykatën e Lartë.

Në vlerësimin e ndihmësmagjistratit dhe caktimin e pikëve Këshilli mund të marrë parasysh nëse burimet e vlerësimit përmbajnë informacione mbi sjellje të tij të tilla si:



- mungesë vëmendjeje dhe interesi për respektimin dhe dinjitetin e individëve;
- keqpërdorimi i kohës së punës, personelit dhe burimeve për qëllime private;
- përdorimi i substancave të ndaluara;
- çdo sjellje dhe veprimtari tjetër që cenon apo rrezikon të cenojë imazhin dhe figurën publike të gjyqtarit, gjykatës dhe të sistemit të drejtësisë.

Vlerësuesi përqendrohet në vendimet përfundimtare për masat disiplinore brenda periudhës së vlerësimit, rezultatet e ankesave dhe verifikimi i tyre, në vetëvlerësimin e ndihmësmagjistratit, mendimin e Kolegjit, mendimin e Kryetarit dhe në të dhënat e raporteve të Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave. Të dhënat e dala nga burimet e vlerësimit do të analizohen në mënyrë objektive duke shmangur qëndrimin subjektiv të vlerësuesit apo anëtarit të Këshillit, të krijuar mbi bazën e njohjeve personale me ndihmësmagjistratin.

### **C. Paanësia (25 pikë)**

Paanësia e ndihmësmagjistratit nënkupton mungesë paragjykimi në favor ose kundër palëve, apo grupeve të veçanta. Këshilli do të vlerësojë këtu imunitetin ndaj çdo ndikimi ose presioni të jashtëm, aftësinë e ndihmësmagjistratit për të shmangur një konflikt të mundshëm interesi që ndikon ose mund të krijojë dyshime për paanësinë e tij, si dhe respektimin e çështjeve të grupeve në nevojë, duke përfshirë edhe çështjet e barazisë gjinore dhe të pakicave. Ndhmësmagjistrati, pavarësisht se nuk ka vendimmarrje të drejtpërdrejtë, duhet të jetë i drejtë dhe i balancuar, duke u përpjekur maksimalisht që ti transmetojë nga jashtë këto cilësi. Paraqitja dhe cilësia e drejtësisë janë thelbësore.

#### **a. Përdorimi ose jo i gjuhës diskriminuese (10 pikë)**

Ndhmësmagjistratët duhet të jenë të vetëdijshëm dhe të shmangin përdorimin e gjuhës diskriminuese si dhe çdo tendencë për paragjykime. Qëndrimet personale nuk duhet të ndërhyjnë në ushtrimin e funksionit të ndihmësmagjistratit.

Si burime vlerësimi lidhur me këtë kriter, shërbejnë dokumentet ligjorë të dorëzuara nga ndihmësmagjistrati, vetëvlerësimi i tij, mendimi i Kolegjit dhe mendimi i Kryetarit.

Pikëzimi bëhet sipas tabelës së mëposhtme:

<b>Aftësia për të shmangur përdorimin e gjuhës diskriminuese</b>	<b>Nr. i pikëve</b>
E dobët	2
Nën mesataren	4
Mesatare	6
Mbi mesataren	8

Shumë e lartë	10
---------------	----

### **b. Numri tejet i lartë i kërkesave për heqje dorë të refuzuara nga Kryetari (15 pikë)**

Pikëzimi i këtij treguesi bëhet sipas një rendi zbritës bazuar në prezumimin e paanshmërisë në funksion. Në bazë të kësaj qasjeje edhe ndihmësmagjistrati, i cili ka funksion primar qenien gjyqtar, e fillon procesin e vlerësimit me totalin e 15 pikëve referuar këtij kriteri.

Për të vendosur nëse numri i kërkesave të refuzuara për heqjen dorë të ndihmësmagjistratit në çështje të caktuara gjyqësore është apo jo “tejet i lartë”, vlerësuesi, rast pas rasti, do të përqendrohet në raportin e numrit të çështjeve të caktuara ndihmësmagjistratit gjatë periudhës së vlerësimit dhe numrit të kërkesave të bëra prej tij për heqje dorë (mospërfshirjen në përgatitjen e materialeve lidhur me çështjen në gjykim), të refuzuara nga Kryetari. Nëse nga burimet e vlerësimit rezulton numër “tejet i lartë” i kërkesave për heqje dorë, ndihmësmagjistrati do të vlerësohet me pikët minimale

I njëjti vlerësim bëhet edhe në rastin kur gjatë procedurës së vlerësimit konstatohet se kërkesat e bëra nga ai për të hequr dorë nga përgatitja e dokumenteve ligjore për çështje të caktuara, janë të përsëritura, pavarësisht refuzimit të mëparshëm për të njëjtin shkak nga Kryetari.

Pikëzimi bëhet sipas tabelës së mëposhtme:

Numri i kërkesave të refuzuara	Nr. i pikëve
Tejet i lartë	3
I pakonsiderueshëm	15

Vlerësuesi përqendrohet në të dhënat statistikore, vlerësimin e kryer nga ndihmësmagjistrati dhe mendimi i Kryetarit.

## **4. AFTËSIA PERSONALE DHE ANGAZHIMI PROFESIONAL (100 pikë)**

Ky kriter vlerëson kapacitetin personal dhe angazhimin profesional të ndihmësmagjistratit që detajohet në treguesit e mëposhtëm.

### **A. Aftësia e komunikimit (40 pikë)**

#### **a. Komunikimi i qartë dhe transparent (25 pikë)**

Ndihmësmagjistrati duhet të jetë në gjendje të komunikojë në mënyrë efektive. Aftësitë e komunikimit efektiv përfshijnë aftësinë për t’u shprehur në mënyrë të kuptueshme, të qartë dhe koncize me gjyqtarët e Gjykatës, publikun (nëse është rasti), subjektet e tjera dhe të tretët.

Pikëzimi bëhet sipas tabelës së mëposhtme:

Qartësia dhe transparenca e komunikimit	Nr. i pikëve
---	--------------

E dobët	5
Nën mesataren	10
Mesatare	15
Mbi mesataren	20
Shumë e lartë	25

Si burime vlerësimi lidhur me këtë tregues, shërbejnë vlerësimi i ndihmësmagjistratit, mendimi i Kolegjit dhe mendimi i Kryetarit.

### **b. Respektimi i konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale (15 pikë)**

Ndihmësmagjistrati duhet të tregojë kujdes maksimal për ruajtjen e konfidencialitetit dhe për mbrojtjen e të dhënave personale në lidhje me informacionet dhe të dhënat për të cilat ai vihet në dijeni për shkak të funksionit, siç mund të jenë çështjet me të mitur, ato të dhunës në familje, etj. Pikëzimi i këtij treguesi bëhet sipas një rendi zbritës, duke prezumuar që ndihmësmagjistrati i gëzon cilësi të tilla. Çdo ndihmësmagjistrat e fillon pikëzimin me 15 pikë, të cilat zbriten sipas tabelës së mëposhtme në varësi të treguesve që dalin nga burimet e vlerësimit.

<b>Respektimi i konfidencialitetit</b>	<b>Nr. i pikëve</b>
I dobët	3
Mesatar	9
I lartë	15

Si burime vlerësimi lidhur me këtë tregues, shërbejnë vetëvlerësimi i ndihmësmagjistratit, mendimi i Kolegjit, mendimi i Kryetarit dhe aktet e dosjeve të përzgjedhura me short.

## **B. Aftësia për të bashkëpunuar (25 pikë)**

### **a. Gatishmëria dhe shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët, duke përfshirë shkëmbimin e njohurive dhe përvojës profesionale me ta (10 pikë)**

Ndihmësmagjistrati duhet të ketë aftësinë dhe disponibilitetin për të bashkëpunuar me kolegët pa cenuar pavarësinë e tij. Ai duhet të kontribuojë në ngritjen e problemeve, diskutimin dhe propozimet mbi çështje të caktuara juridike, përmirësimet e legjislacionit, diskutimin rreth zbatimit apo ndryshimit të vendimeve njësuese, hartimin e modeleve të unifikuara të akteve procedurale, dhe çdo çështje tjetër që lidhet me veprimtarinë gjyqësore. Ndihmësmagjistrati duhet të tregojë gatishmëri për të ndarë me kolegët përvojën e përfutur në aktivitetet e ndryshme trajnuese.

Pikëzimi bëhet sipas tabelës së mëposhtme:

<b>Shkalla e komunikimit</b>	<b>Nr. i pikëve</b>
E dobët	2
Nën mesataren	4
Mesatare	6

Mbi mesataren	8
Shumë e lartë	10

Si burime vlerësimi lidhur me këtë tregues shërbejnë vetëvlerësimi i kryer nga ndihmësmagjistrati, mendimi i Kryetarit dhe të dhënat për verifikimin e ankesave të paraqitura ndaj tij gjatë periudhës së vlerësimit, nëse ka.

### **b. Gatishmëria dhe kontributi për të kryer detyra të tjera që i ngarkohen nga organet drejtuese të Gjykatës (5 pikë)**

Ndihmësmagjistratët ushtrojnë funksion ndihmës pranë Gjykatës së Lartë dhe si të tillë ata duhet të jenë të gatshëm të japin kontributin e tyre jo vetëm në lidhje me çështjet gjyqësore që shqyrtohen nga gjykata, por edhe për çështje të tjera që mund të lidhen me të, si p.sh: propozime për ndryshime ligjore, përmirësimin e akteve të brendshme rregulluese të gjykatës, organizimin më eficient të administratës gjyqësore, etj. Ky angazhim ndihmon jo vetëm në përmirësimin e punës në Gjykatën e Lartë ku ndihmësmagjistrati është komanduar, por aftëson këtë të fundit në kryerjen e detyrave të tjera, përveç atyre me karakter të pastër gjyqësor.

Duke marrë parasysh se angazhimi në veprimtari të tilla jo gjithmonë është në varësi të vullnetit të ndihmësmagjistratit, të gjithë e fillojnë vlerësimin për këtë tregues me 3 pikë. Dy pikë të tjera iu shtohen në vlerësim ndihmësmagjistratëve, për të cilët nga burimet e vlerësimit rezultojnë të dhëna mbi përfshirjen në përgatitjen e produkteve konkrete.

Si burime vlerësimi lidhur me këtë tregues shërbejnë vetëvlerësimi i kryer nga ndihmësmagjistrati dhe mendimi i Kryetarit.

### **c. Aftësia për të bashkëpunuar dhe për të reaguar me efikasitet në rast nevojë (10 pikë)**

Ndihmësmagjistrati duhet të tregojë aftësi për të qenë bashkëpunues, për të reaguar me efikasitet në raste të shfaqjes së problemeve apo vështirësive gjatë punës, duke ruajtur qetësinë, etikën dhe duke synuar zgjidhjen e menjëhershme dhe efektive të konfliktit. Në këtë aspekt vlerësohet veçanërisht marrëdhënia korrekte e ndihmësmagjistratët me gjyqtarët, kancelarin dhe administratën gjyqësore, aftësia e tij për të shmangur situata konflikti apo për të ofruar zgjidhje të tyre nëse është e nevojshme. Kjo mënyrë sjelljeje nxit marrëdhëniet bashkëpunuese me stafin e gjykatës duke krijuar një ambient pune harmonik dhe produktiv.

Korrektësia dhe gatishmëria për të ndërtuar marrëdhënie sa më të mira pune vlerësohet nga Kryetari i Gjykatës. Pikëzimi i këtij treguesi bëhet sipas një rendi zbritës, duke prezumuar praninë e cilësive të tilla. Çdo ndihmësmagjistrat e fillon pikëzimin me 10 pikë, të cilat zbriten sipas tabelës së mëposhtme në varësi të treguesve që dalin nga burimet e vlerësimit.

Pikëzimi bëhet sipas tabelës së mëposhtme:

Shkalla e aftësisë	Nr. i pikëve
E dobët	2
Nën mesataren	4

Mesatare	6
Mbi mesataren	8
Shumë e lartë	10

Si burime vlerësimi lidhur me këtë tregues, shërbejnë vetëvlerësimi i ndihmësmagjistratit dhe mendimi i Kryetarit.

### C. Gatishmëria për t'u angazhuar në veprimtari të tjera (35 pikë)

#### **a. Pjesëmarrja në programet e formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës dhe në trajnime të tjera profesionale (20 pikë)**

Një nga objektivat e vlerësimit të veprimtarisë profesionale është edhe identifikimi i nevojave për trajnim, duke i dhënë mundësi ndihmësmagjistratit t'i kushtojë kohë vetëpërmirësimit në lidhje me njohjen dhe zbatimin e ligjit, jurisprudencës dhe doktrinës. Me qëllim ngritjen e tyre profesionale, ndihmësmagjistratët kanë detyrimin ligjor të ndjekin programin e formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës. Ata duhet t'i kushtojnë kohë evoluimit të mendimit juridik dhe jurisprudencës dhe të ndjekin programe trajnimi që nxitin specializimin e organizuar edhe nga institucione të tjera trajnimi në nivel kombëtar ose ndërkombëtar, të njohura nga Këshilli.

Në lidhje me pikëzimin e aftësisë së ndihmësmagjistratit për t'u angazhuar në veprimtari të tjera, treguesi i pjesëmarrjes në programin e formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës, matet duke u bazuar në informacionin me shkrim që përcillet nga Shkolla e Magjistraturës, i cili vërteton pjesëmarrjen dhe përfshirjen e magjistratit në trajnime. Pjesëmarrja e ndihmësmagjistratit në trajnime të tjera vlerësohet bazuar në dokumente të dorëzuara prej tij që tregojnë ngritjen profesionale.

Pikëzimi i këtij treguesi bëhet referuar numrit të trajnimeve dhe kohëzgjatjes tërësore të tyre në raport me një temë të caktuar. Këshilli konsideron vlerë të shtuar për ngritjen profesionale trajnimet afatgjata, përfshirë edhe trajnimet afatshkurtra të specializuara në një fushë të caktuar, të organizuara në periudha kohore të ndërprera.

Si burime për pikëzimin shërbejnë vetëvlerësimi i kryer nga ndihmësmagjistrati, të dhënat e dosjes personale të ndihmësmagjistratit, informacioni i marrë nga Shkolla e Magjistraturës, si dhe çdo e dhënë tjetër, që tregon ngritjen profesionale të tij.

Pikëzimi bëhet sipas tabelës së mëposhtme.

<b>Pjesëmarrja</b>	<b>Nr. i pikëve</b>	<b>Pjesëmarrja</b>	<b>Nr. i pikëve</b>
Periudha 3- vjeçare	15-120 ditë: 20 pikë	Periudha 5-vjeçare	30-200 ditë: 20 pikë

	<15 ose >120 ditë: 4 pikë		<30 ose >200 ditë: 4 pikë
--	------------------------------	--	------------------------------

### **b.Disponueshmëria e ndihmësmagjistratit për trajnimin e gjyqtarëve (5 pikë)**

Me anë të këtij kriteri, Këshilli konsideron vlerë të shtuar për gjyqtarin gatishmërinë e tij për të kontribuar si ekspert/lehtësues në trajnimin fillestar apo vazhdues të Shkollës së Magjistraturës, apo në trajnime të organizuara nga institucione të tjera.

Duke marrë parasysh se pjesëmarrja në veprimtari të tilla, jo gjithmonë është në varësi të vullnetit të ndihmësmagjistratit, të gjithë e fillojnë vlerësimin për këtë tregues me 3 pikë. Dy pikë të tjera iu shtohen në vlerësim ndihmësmagjistratëve që kryejnë këtë veprimtari njëkohësisht me veprimtarinë gjyqësore, pavarësisht nga frekuenca e angazhimit.

Burim vlerësimi për këtë kriter është dosja personale e ndihmësmagjistratit dhe informacioni me shkrim që përcillet nga Shkolla e Magjistraturës ose institucione të tjera, i cili vërteton pjesëmarrjen dhe përfshirjen e gjyqtarit në veprimtaritë trajnuese.

### **c. Pjesëmarrja në veprimtari ndërinstitucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësisë (5 pikë)**

Ndihmësmagjistrati gjatë periudhës që është i komanduar mund të angazhohet dhe të bëjë përpjekje për të përmirësuar sistemin e drejtësisë në mënyra të ndryshme. Këto përfshijnë veprimtari jashtë funksionit, me ose pa pagesë, të tilla si: fjalime publike; prezantime në konferenca shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare; pjesëmarrja në programet e edukimit të komunitetit; bashkëpunimi me Këshillin për përmirësimin e programeve të formimit vazhdues; angazhimi si ekspert në punët e Këshillit për përgatitjen e formave standarde me qëllim rritjen e efikasitetit; kontribute në hartimin e legjislacionit; aktivitete mësimdhënëse për çështje ligjore; bashkëpunimi me grupe interesash të ndryshëm me qëllim rritjen e cilësisë së gjyqësorit dhe ndërgjegjësimin e publikut për forcën e zbatimit të ligjit, si edhe çdo veprimtari tjetër e ngjashme në fushën juridike. Pjesëmarrja në këto veprimtari duhet të respektojë jo vetëm kuadrin ligjor, por edhe rregullat përkatëse të etikës të miratuara nga Këshilli për këtë qëllim.

Duke marrë parasysh se pjesëmarrja në veprimtari të tilla, jo gjithmonë është në varësi të vullnetit të ndihmësmagjistratit, vlerësimi për këtë tregues fillon me 3 pikë. Një ose dy pikë të tjera iu shtohen në vlerësim atyre që kryejnë këto veprimtari njëkohësisht me veprimtarinë ndihmëse si të komanduar, duke marrë parasysh sasinë dhe cilësinë e angazhimit, shkallën e pjesëmarrjes së tij, ndikimin në veprimtarinë specifike dhe shtrirjen ndërkombëtare të angazhimit, si dhe çdo e dhënë tjetër që del nga burimet e vlerësimit të këtij treguesi.

Si burime për pikëzimin shërbejnë vetëvlerësimi i kryer nga ndihmësmagjistrati, mendimi i Kryetarit, të dhënat e dosjes personale të ndihmësmagjistratit, si dhe çdo e dhënë tjetër, që tregon ngritjen profesionale të tij.

### **c. Publikimet ligjore akademike (5 pikë)**

Me anë të këtij kriteri, Këshilli konsideron vlerë të shtuar për ndihmësmagjistratin nëse ai publikon shkrime, artikuj ligjorë me natyrë akademike ose praktike me qëllim dhënien e kontributit për zhvillimin e doktrinës apo njohjen e praktikantëve të së drejtës me zhvillimet më të fundit të jurisprudencës vendase dhe të huaj. 1 deri 5 pikë caktohen për publikimet ligjore akademike, ku

përfshihen artikuj, kapituj, monografi, ose publikime shkencore të tjera, të botuara brenda dhe jashtë vendit, të shoqëruara me numër identifikimi (ISBN, ISSN).

Si burim vlerësimi shërbejnë dosja personale e ndihmësmagjistratit dhe çdo e dhënë tjetër, që tregon ngritjen profesionale të tij, të cilat japin të dhëna për sasinë, tipologjinë dhe impaktin e punimeve dhe publikimeve ligjore akademike.

## BURIMET E VLERËSIMIT

Vlerësimi i ndihmësmagjistratit bazohet në këto burime:

- a) dosja personale;
- b) të dhënat statistikore mbi: numrin e çështjeve të caktuara për relativitet; atyre të përgatitura nga ndihmësmagjistrati për çdo vit vlerësimi, pavarësisht përfundimit të tyre me vendim në seancë ose në dhomë këshillimi, lloj rekursi ose çështje të tjera (kërkesa të veçanta që nuk konsiderohen rekurse); kohëzgjatjen e përgatitjes së dokumentit ligjor; numrin e kërkesave për heqje dorë të paraqitura dhe të refuzuara.
- c) çështjet e përzgjedhura me short për vlerësim, që dokumentojnë të gjithë veprimtarinë profesionale të ndihmësmagjistratit (çështje të gjykuara në dhomë këshillimi ose në seancë gjyqësore);
- ç) formulari i vetëvlerësimit të ndihmësmagjistratit dhe opinionet/analizat ligjore të përzgjedhura prej tij (2 (dy) materiale për çdo vit vlerësimi) që lidhen me çështje të veçanta që kërkojnë analizë dhe studim të posaçëm;
- d) formulari i mendimit të kryetarit, lidhur me tregues të veçantë për aftësitë organizative, etikën dhe angazhimin profesional për çështje që lidhen me organizimin dhe funksionimin e Gjykatës;
- dh) formulari i mendimit të Kolegjit lidhur me aftësitë profesionale të ndihmësmagjistratit në përgatitjen dhe paraqitjen e çështjeve ligjore, organizative, dhe etikën në punë ;
- e) informacioni me shkrim që përcillet nga Shkolla e Magjistraturës ose institucione të tjera, i cili vërteton përfshirjen e gjyqtarit në veprimtaritë trajnuese;
- ë) raportet e kërkuara nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave ose institucione të tjera audituese ose kontrolluese;
- f) vendimet përfundimtare për masat disiplinore ndaj gjyqtarit që janë dhënë gjatë periudhës së vlerësimit, në mënyrë të pavarur, nëse masa disiplinore është shuar ose jo;
- g) të dhënat për verifikimin e ankesave të paraqitura ndaj ndihmësmagjistratit gjatë periudhës së vlerësimit;

gj) çdo e dhënë tjetër apo dokument që tregon përfshirjen e magjistratit në dhënien e mendimeve apo materialeve që lidhen me veprimtarinë jashtëgjyqësore si dhe ngritjen profesionale të ndihmësmagjistratit në funksion të formimit të tij të mëtejshëm (botime,